

Aktiviteti: Ditët e informimit të maturantëve

Data: 19.02.2019 - 05.03.2019

Vendi: Qendra Rinore Ten

Në vijim të masave dhe veprimtarive të planifikuara nga MASR, për njohjen, informimin dhe këshillimin e nxënësve maturantë për IAL dhe programet e studimit të ciklit të parë dhe programeve të integruara të ciklit të dytë u zhvillua veprimtaria:

Ditët e informimit të maturantëve nga data 19.02.2019 - 05.03.2019, në mjediset e Qendrës Rinore Ten.

Pjesëmarrësit:

Në këtë aktivitet u përfshi Zyra e Karrierës, Drejtorja e Kurrikulës dhe përfaqësues të çdo Fakulteti të Universitetit Politeknik të Tiranës, të cilët nëpërmjet materialeve promovuese informuan maturantët për programet e studimit dhe kriteret e pranimit në secilin fakultet. Aktiviteti u zhvillua sipas një kalendari, të cilin do ta gjeni bashkëlidhur.

Maturantë nga të gjitha shkollat e mesme publike dhe jopublike të Tiranës morën pjesë në këtë veprimtari. Ata patën një komunikim të gjatë dhe të detajuar me specialistin e zyrës së këshillimit të karrierës së UPT rreth aftësive të tyre, mesatares, lëndët e preferuara dhe morën një orientim se në cilin prej degëve të fakulteteve të UPT mund të studiojnë në vazhdim.

